



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 204, Datë 12.12.2019

MBI

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ENERGIA GAS AND POWER ALBANIA”
SH.P.K., NR. 258, SERIA T14, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-
S NR. 133, DATË 24.12.2014.**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2 gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”; nenit 5, pika 1 gërma “e”; nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE- s Nr.109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 114/1 Prot, datë 02.12.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, për rinovimin e licencës së shoqërisë “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 172, datë 07.11.2019, filloi procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Energia gas and Power Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën nr. 32/48 Prot, datë 07.11.2019 dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k..
- Me shkresën nr. 461/2 Prot, datë 12.11.2019, ERE i’u drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Në përgjigje të sa më sipër, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 461/3 Prot, datë 19.11.2019, shoqëria “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k ka përcjellë dokumentacionin e munguar i cili është pasqyruar në pjesët takuese të saj.
- Shoqëria “Energia Gas And Power Albania” sh.p.k., është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar. Në datën 11.06.2014 dhe është e rregjistruar pranë QKB, si shoqëri aksionere (sh.a.), konform Ligjit Nr. 9723,

datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit”, i ndryshuar, me numër identifikimi (NUIS) L41811003F.

- Shoqëria “Energia Gas And Power Albania” sh.p.k., është mbajtëse e licencës me nr. 258, Seria T14 në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 133, datë 24.12.2014, me afat 5 vjeçar, kjo licence përfundon në datën 24.12.2019.
- Referuar sa më sipër konstatohet se shoqëria “Energia Gas And Power Albania” sh.p.k, ka aplikuar brenda afatit ligjor të nevojshëm për rinovim licences.

Aplikimi i shoqërisë “Energia Gas And Power Albania” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “Energia Gas And Power Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike me nr. 258, Seria T14, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 133, datë 24.12.2014, për një afat 5 vjeçar, duke filluar nga data 25.12.2019.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI